

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR
Elite Albania Sh.p.k.**

● Znj. Elvisa Kola, atësia Vasil datëlindje 26.03.1990, lindur në Dardhë dhe banuese në Tiranë.

kam vendosur të nënshkruaj Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është **Elite Albania Sh.p.k.**

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga Frederik Shiroka, Nr.10/1, Ap. 20

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 - Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

- Te operoje ne sektorin e telekomunikacionit duke kryer çdo lloj veprimtarie nepermjet telefonit per llogari te vet apo te treteve me seli ne Shqiperi apo ne çdo vend tjetër qe ka lidhje me Republikën e Shqiperise, duke respektuar ligjin ne fuqi; Te kryej aktivitete nepermjet telefonit te cdo lloji per llogari te vet apo te treteve, telemarketing, sekretari telefonike, shitje nepermjet telefonit, sondazhe, mesazhe promocionale dhe çdo lloj tjetër aktiviteti lidhur me te, ku persa permendur me siper nuk mund te jete saktesisht apo e kufizuar; Te bleje e te shese ose te jape me qera, ne perdorim, ne uzufukt, ose ne shfrytezim pasuri te luajtshme e pasuri te paluajtshme e te regjistruara ne regjistrat publike. Te bleje pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera qe kane objekt te ngjashem apo te afert me te vetin. Shoqeria mund te kete pjesemarrje ne formen e mbajtjes se aksioneve/kuotave apo interesave te tjera ne shoqeri tregtare apo ndermarrje me objekt veprimtarie te çfaredo lloji.

Neni 5 - Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 530,000 (pesëqind e tridhetë mijë) ALL i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakeve në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të ketij Akti.

Neni 6 - Kontributet

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Znj. Elvise Kola, atësia Vasil datëlindje 26.03.1990, të cilës i përket një kuotë, me vlerë nominale 530,000 ALL që i korespondon 100% i kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 - Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Znj. Elvise Kola, atësia Vasil datëlindje 26.03.1990 emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare

- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9- Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKU
Elvise Kola

Data: 19.09.2023

